KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR

**Objekti:** **Shërbime Organizimi të Eventeve Sportive (CPV – 92622000-7)**

**Tabela e Përmbajtjes**


***Terma Referencë për Organizim Eventi Sportiv të organizuar nga "Ekipet Sportive në Shkolla"***
***Shërbime redaktimi, përpunimi dhe përkthimi të revistave dhe buletineve në kuadër të projektit "Ekipet Sportive në Shkolla".***

***Ref: Shërbime Rekreative Kulturore dhe Sportive*** **...............................................................**

1. **Rreth KOKSH ..........................................................................................2**
2. **Rreth shërbimit të kërkuar.........................................................................2**
3. **Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.............................................4**
4. **Metodologjia dhe plani i punës .....................................................................3**
5. **Kualifikimet e nevojshme ............................................................................3**
6. **Procesi i aplikimit.......................................................................................4**
7. **Dorëzimi i ofertave .....................................................................................5**
8. **Afati i Aplikimit.........................................................................................6**
9. **Procesi i Vlersimit.......................................................................................6**
10. **Informacion nese eshte perdorur njoftim paraprak ..............................................6**

ALBANIAN NATIONAL OLYMPIC COMMITTEE

KOMITETI OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR

## 1. Rreth KOKSH

KOKSH është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj.

KOKSH është pjesë e Lëvizjes Olimpike dhe angazhohet plotësisht të respektojë Kartën Olimpike dhe Kodin Antidoping të Lëvizjes Olimpike, si dhe të jetë konform me vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe legjislacionin e shtetit Shqiptar.

## 2. Objekti i shërbimit të kërkuar: Sherbime organizimi te ngjarjeve sportive dhe kulturore.

Për të përmbushur misionin e organizatës dhe për të mbështetur zbatimin e projektit "Ekipet Sportive në Shkolla", KOKSH planifikon të sigurojë shërbime profesionale të redaktimit, përpunimit gjuhësor dhe përkthimit të revistave dhe buletineve informuese. Këto shërbime synojnë përgatitjen cilësore të materialeve të shkruara që lidhen me aktivitetet e projektit, duke përfshirë raportimet mbi zhvillimin e aktiviteteve sportive në shkolla, informacionet mbi ndeshjet dhe eventet e organizuara në kuadër të projektit, si dhe materialet promovuese dhe informuese për publikun.

Shërbimet e kërkuara përfshijnë redaktimin gjuhësor dhe teknik të përmbajtjes, përshtatjen e saj për publikim në revista dhe buletine, si dhe përkthimin e materialeve në gjuhët e nevojshme, në përputhje me standardet e komunikimit institucional dhe kërkesat e projektit.

Ftojme individët/kompanitë me aktivitet veprimtarie ne shërbimet e kërkuara te medias vizive që janë të interesuar të bashkëpunojë.

Nëpërmjet kësaj thirrje të hapur, KOKSH fton individët/kompanitë e interesuara të paraqesin ofertën e tyre sipas specifikimeve të mëposhtme.

## 3. Cfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij bashkëpunimi.

| Nr | Emërtimi | Specifikim Teknik | Njësia | Sasia | Cmim pa Tvsh | Vlera | Burimi i Financimit | Kohezgjatja/Periudha |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *a* | *b* | *c* | *d* | *1* | *2* | *3=1x2* | *4* | *5* |
| 1 | Shërbime redaktimi, përpunimi dhe përkthimi të revistave dhe buletineve në kuadër të projektit “Ekipet Sportive në Shkolla” konkretisht: Revista Team Albania Redaktim (Shqip – 178 faqe) Redaktim + Perkthim (Anglisht – 178 faqe Redaktim Teknik dhe gjuhesor buletinesh | Shërbime profesionale të redaktimit gjuhësor, përpunimit editorial dhe përkthimit të materialeve informuese, revistave dhe buletineve të projektit, përfshirë përshtatjen për publikim dhe standardizimin e përmbajtjes institucionale | Nr sherbimesh | Rast pas rasti sipas nevojave | leke | | Qeveria Shqiptare financim projekti “Ekipet Sportive ne Shkolla”. | Afatet e dorëzimit për çdo material do të përcaktohen rast pas rasti nga Autoriteti Kontraktor, në varësi të volumit dhe urgjencës së materialit. |

## 4. Metodologjia dhe plani i punës

Për realizimin me cilësi të këtij shërbimi, do të përzgjidhet individi, ekipi ose operatori ekonomik që paraqet ofertën më të favorshme në përputhje me kushtet teknike dhe financiare të përcaktuara në këtë dokument.
Metodologjia e ndjekur do të përfshijë:
Identifikimin dhe përzgjedhjen e operatorit ekonomik përmes një procesi transparent dhe konkurrues;

Hartimin e një plani pune të detajuar për redaktimin, përpunimin dhe përkthimin e revistave dhe buletineve të projektit "Ekipet Sportive në Shkolla", në bashkëpunim me autoritetin kontraktor dhe në përputhje me kalendarin e publikimeve të miratuara;
Koordinimin e vazhdueshëm me strukturat përgjegjëse të projektit për marrjen, verifikimin dhe finalizimin e materialeve që do t'i nënshtrohen redaktimit dhe përkthimit;
Redaktimin gjuhësor dhe teknik të materialeve, përfshirë përmirësimin e stilit, strukturës dhe koherencës së përmbajtjes;
Përkthimin e materialeve në gjuhët e kërkuara, duke siguruar saktësi dhe përshtatje të terminologjisë institucionale;
Dorëzimin e materialeve të përpunuara brenda afateve të përcaktuara për çdo publikim, sipas kërkesave të projektit;
Monitorimin e cilësisë së shërbimit gjatë gjithë periudhës së zbatimit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të projektit, për të garantuar standard të lartë të materialeve të publikuara.
Kohëzgjatja maksimale e këtij shërbimi është 6 muaj, 1 janar – 30 qershor 2026 dhe do të mbulojë të gjitha materialet e planifikuara për publikim në kuadër të projektit "Ekipet Sportive në Shkolla", sipas kalendarit zyrtar të publikimeve të miratuara.

## 5. Kualifikimet e nevojshme

**Kualifikimet:**

- Regjistrimi ligjor – Subjekti duhet të jetë i regjistruar në QKB dhe të ketë në objekt të veprimtarisë shërbime redaktimi, përkthimi, botimi, shërbime gjuhësore ose shërbime të ngjashme profesionale;
- Të paraqesë ofertën sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor;
- Të sigurojë stafin e kualifikuar me eksperiencë në redaktim gjuhësor, përpunim editorial dhe përkthim profesional të materialeve institucionale;
- Të ketë kapacitet profesional dhe organizativ për realizimin e shërbimeve brenda afateve të përcaktuara.
- Për të qenë i përshtatshëm për këtë prokurim, ofertuesi duhet të plotësojë këto kritere kualifikuese:
- Eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve të redaktimit, përkthimit, përpunimit editorial ose përgatitjes së materialeve të ngjashme (revista, buletine, publikime institucionale);
- Aftësi për të ofruar shërbimin sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, përfshirë cilësinë gjuhësore, saktësinë terminologjike dhe respektimin e afateve;

- Përgatitjen e një oferte të detajuar që pasqyron qartë metodologjinë e punës, procesin e redaktimit dhe përkthimit, si dhe kostot e shërbimit;
- Kapacitet teknik dhe profesional për përdorimin e mjeteve të nevojshme për redaktim, përpunim dhe formatim të materialeve për publikim;

Procesi i aplikimit

Për të aplikuar në këtë thirrje kërkohet:

- Oferta Financiare per event.
- NIPT-in e biznesit
- Adresen e sakte dhe person kontakti.
-

## 6. Dorëzimi i ofertave

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

*Tirana Olympic Park*
*Rr. "Liman Kaba"*
*Tiranë, Shqipëri*
*P.O. Box 63*
*Email: secretary.general@nocalbania.org.al*

## 7. Afati i Aplikimit

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 03.12.2025 jo më vonë se ora 16:00.
- Ofertat duhet te dorezohen ne gjuhen Shqipe.
-

## 8. Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi do të kryhet sipas sistemit të pikëzimit si më poshtë vijon:

| Përshkrimi | Pesha në vlerësim % |
|---|---|
| **Çmimi-** Vlerësohet oferta më e favorshme ekonomikisht, bazuar ne cmim | 30% |

| | |
|---|---|
| **Cilësia dhe kapaciteti** – Vlerësohet cilësia e realizimit, metodologjia e punës, përvoja dhe kapacitetet profesionale të operatorit ekonomik për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale brenda afateve të përcaktuara. | 70% |

## 9. Informacion nese eshte perdorur njoftim paraprak.

Nuk eshte perdorur njoftim paraprak ne lidhje me kete lloj sherbimi te kerkuar.